

30

KËSHILLA

**PËR NJË RAMAZAN PRODUKTIV
DHE PA GABIME**

30 këshilla

Për një Ramazan pa gabime

Nga: Abu Productive

Ramazani produktiv

Përgatitur nga ProductiveRamadan.com (projekt i ProductiveMuslim.com)

Dizajni: Mohamed Alaa Shoukry

www.mohamedalaa.com

Përktheu në gjuhën shqipe: Hekuran Helshani

Boton: Literaturaislame.com

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	3
Dita 1	12
Dita 2	13
Dita 3	14
Dita 4	15
Dita 5	16
Dita 6	17
Dita 7	18
Dita 8	19
Dita 9	20
Dita 10	21
Dita 11	22
Dita 12	23
Dita 13	24
Dita 14	25
Dita 15	26
Dita 16	27
Dita 17	28
Dita 18	29
Dita 19	30
Dita 20	31
Dita 21	32
Dita 22	33
Dita 23	34
Dita 24	35
Dita 25	36
Dita 26	37
Dita 27	38
Dita 28	39
Dita 29	40
Dita 30	41

Një Ramazan pa gabime?

Dëshironi të keni një Ramazan pa gabime? Një Ramazan ku nuk do të shtoni peshë nga ngrënia e tepërt nëpër iftare, ku nuk do të humbisni asnjë syfyr në mënyrë që të mos ndjeheni të lodhur të nesërmen në punë, madje, ta mbaroni leximin e Kuranit gjatë muajit, të falni të gjitha teravitë/namazet vullnetare (dhe sigurisht, namazet e detyrueshme) në kohë dhe me përqendrim të përsosur, të fokusohuni në ibadet intensivisht në netët e fundit të Ramazanit në vend që të shkoni në një furi të çmendur pazaresh për Bajram?

Tingëllon e pamundur, apo jo?

Le të zbulojmë. Vazhdo të lexosh.

Veç sikur të filloje pak më herët...

Çdo Ramazan, i thua vetes të njëjtat fjalë:

"Sikur të filloja të përgatitesha për Ramazanin më herët...!"

"Sikur të bëja blerjet e Bajramit para fillimit të Ramazanit...!"

"Sikur të praktikoja faljen e namazit të natës (tehaxhud) dhe zgjimin para Sabahut...!"

"Sikur të kisha mësuar më shumë për agjërimin, ashtu që të mos mbërthehem me pyetje të rastësishme pa përgjigje...!"

Dhe cili është rezultati i kësaj zvarritjeje? Shikoni historinë më poshtë dhe shikoni nëse tingëllon e njohur (madje, ndoshta goxha e njohur).

Ai ishte shumë i lumtur kur dëgjoji njoftimin në radio se Ramazani kishte arritur! Sytë e tij u mbushën me lot dhe zemra i fluturonte: "Elhamdulillah", - tha ai, "Allahu më ka bekuar që të jetoj për të arritur edhe një Ramazan!"

Ahmedi e kishte pritur këtë ditë, duke pritur fillimin e Ramazanit, veçanërisht këtë vit. Ai sapo filloi ta kuptonte më mirë fenë e tij dhe me të vërtetë donte të praktikonte gjithë atë njohuri që mësoi dhe ta bënte Ramazanin një përvojë vërtet transformuese, shpirtërore për veten e tij.

Ai vrapoi lart në dhomën e tij për t'u përgatitur për teravitë, bëri një dush, veshi rrobat e tij më të mira dhe u mbush me aq shumë parfum saqë mamaja e tij e nuhati aromën nga kati i poshtëm.

"Ahmed! Po vure edhe pak parfum do të shndërrohesh në një tezgë lëvizëse e parfumeve! Eja poshtë, darka është gati!"

"Po vijë, mami!" - u përgjigj ai.

Fytyra e tij po shkëlqente. E gjithë familja e tij ishte shumë krenare që po shihte këtë djalë të ri musliman aq të entuziazmuar dhe të gatshëm për Ramazan.

Por, ja që, me të arritur ditën e shtatë të Ramazanit, diçka filloi të shkojë keq... i shkonte syfyri pa ngrënë, flinte gjatë kohës së namazit të sabahut dhe puna iu bë aq e vrullshme saqë nuk mund të dilte për teravi për disa netë; gjithashtu, ai po merrte pjesë tashmë në shumë iftare dhe ushqimi është aq i mrekullueshëm saqë është tepër i ngopur për të falur 2 rekate teravi pas tij!

"Çfarë ka që nuk shkon me mua?" - pyet ai veten. "Po e humbas, nuk po e ndjej atë aromën e njëjtë të Ramazanit që kisha në ditët e para...?!"

Ai po e ndjen se gjërat kanë filluar të marrin tatëpjetën. Është data 15 e Ramazanit dhe ai mezi e ka mbaruar xhuzin e 10-të dhe i premtos vetes se do ta arrijë gjatë fundjavës... thjesht, puna është e çmendur gjatë javës dhe ai mezi ia del të përqendrohet, agjërimi po i bëhet më i vështirë dhe shefi i tij nuk është i kënaqur me produktivitetin e tij.

Ai po ndihet shumë keq: "Ja që edhe ky paska qenë një nga ata Ramazanët (e zakonshëm)...!"

Ai e shtyn veten në ditët e fundit: iftar, teravi, syfyr, duke i përsëritur. Dhe, para se ai ta kuptojë --- tashmë ka mbaruar.

Ramazani mbaroi dhe ai nuk mori më të mirën prej tij! Ramazani mbaroi dhe ai nuk e ndjeu përvojën shpirtërore transformuese që shpresonte të ndjente! Ramazani ka mbaruar dhe ai ndihet fajtor.

Ai ndihet shumë i trishtuar. Qan dhe i premtos vetes se nëse vjen Ramazani i ardhshëm, ai nuk do të ketë tjetër "Ramazan fajtor".

Tregimi i mësipërm është një tregim fiktiv për Ahmedin, mirëpo ai shpërfaq përvojën e shumë prej nesh. Në secilin Ramazan, futemi me aq shumë shpresë, por vetëm pas disa ditëve ngecim dhe e pranojmë disfatën - Ramazani mbaron dhe ne ndjehemi fajtorë, duke i treguar vetvetes se në Ramazanin tjetër do të bëjmë më shumë, për të përsëritur të njëjtin model herëve të tjera.

Këtë, unë e quaj rrugëtimi i gabuar nëpër Ramazan.

Para se të zhytem në shkaqet e rrugëtimit të gabuar nëpër Ramazan, dua të ta bëjë një pyetje: Në ciklin e pritshëm jetësor të një qenie njerëzore, sa Ramazane mund t'i përjetojë një musliman?

40 Ramazane? 60 Ramazane? Nuk janë shumë, apo jo? Nëse ne nuk përfitojmë më të mirën nga këto Ramazane, si do të qëndrojmë para Allahut të Lartësuar në Ditën e Gjykimit, kur kemi nevojë edhe për sasinë më të vogël të veprave të mira?!

Mendo rreth kësaj!



10 shkaqet për rrugëtimin e gabuar nëpër Ramazan!

Pra, cilat janë arsyet për të rënë në këtë rrugëtim të gabuar çdo muaj të Ramazanit? Këtu janë 10 arsyet që unë i kam menduar:

1. Pritjet jorealiste: Çdo vit ne hyjmë në Ramazan me pritshmëri jashtëzakonisht të lartë nga vetja. Sa herë keni dëgjuar njerëzit t'i premtojnë vetes se do ta mbarojnë Kuranin 5 herë këtë Ramazan; apo se do të falin teravitë dhe namazin e natës (tehexhudin) çdo natë? Nuk ka asgjë të keqe me aspiratat e larta; në fakt, ne gjithmonë duhet të kemi synime të larta për të sfiduar dhe përmirësuar veten tonë. Por, duke e njohur veten, ne nuk duhet t'i bëjmë qëllimet tona joreale, duke i bërë kështu vetes një presion të madh psikologjik. Pra, kur ndiejmë se kemi “rrëshqitur”, qoftë edhe pak, humbasim çdo shpresë për t'ia dalë mbanë dhe biem në sindromën e “oh, epo ndoshta vitin e ardhshëm”, në vend që të ri-rregullojmë planet dhe pritshmërinë tonë.

2. Ne nuk lehtësohemi në Ramazan: Ne shohim një transformim të madh në veten tonë gjatë ditëve të para të Ramazanit - ne zgjohemi një orë më herët, para sabahut, edhe pse mund të mos jemi të trajnuar për t'u zgjuar aq herët gjatë ditëve normale. Ne falim 20 rekate teravi, ndërkaq, më parë, mezi i falnim namazet sunet. Ne lexojmë 10-20 faqe Kuran çdo ditë, kur zakonisht mezi lexojmë një ose dy faqe në javë!

Cili është rezultati i kësaj shtytjeje të madhe? Është se ne mund ta mbajmë atë vetëm për disa ditë - pastaj humbasim gjurmët, kuptojmë se është shumë e vështirë dhe kthehemi tek niveli i parë.

3. Mungesa e qëndrueshmërisë: Në momentin që arrijmë në mes të Ramazanit, orari ynë i ngjeshur fillon të na pushtojë dhe rrëshqasim; rutina jonë e përditshme e leximit të 10 faqeve të Kuranit pas sabahut nuk po zhvillohet më; pjesëmarrja në teravi çdo natë, shpejt shndërrohet në çdo të dytën natë; zgjimi për tehexhud zëvendësohet me zgjimin pak para sabahut për syfyri; kështu, ne braktisim qëndrueshmërinë mu atëherë kur më së shumti kemi nevojë për të.

4. Mungesa e njohurive: Mospajisja e vetes me njohuri praktike për të shfrytëzuar pjesën më të madhe të Ramazanit është një faktor i madh për të pasur një rrugëtim të gabuar nëpër Ramazan. Mungesa e të kuptuarit të vlerës së vërtetë të Ramazanit dhe mungesa e të kuptuarit të përbërësve psikologjikë, fizikë dhe emocionalë për të pasur një Ramazan të plotë, është gjithashtu një faktor.

5. Mungesa e mbështetjes së komunitetit: Ramazani konsiderohet betejë personale për secilin prej nesh. Askush nuk flet sinqerisht për përvojat e tyre shpirtërore dhe se sa mirë po i përmbahen objektivave të Ramazanit. Në fakt, duket sikur në Ramazan jemi duke e luftuar vetveten. Nuk ka shumë grupe mbështetëse ose diskutime - vetëm unë, dhe vetja ime.

6. Mungesa e menaxhimit të kohës: “Menaxhimi i kohës? Çfarë menaxhimi të kohës? Hmm.., mos e ke fjalën për atë gjë kur duhet t’u përmbahesh detyrave të caktuara në kohë të caktuara...?! Vëlla, të lutem, për çfarë po flet? Ky është Ramazan, gjërat janë ndryshe në Ramazan... është Ramazan! Nuk e menaxhojmë dot kohën në Ramazan, do të ishte mirë të gjejmë kohë për të fjetur siç duhet, o burrë...” E pushoj rastin.

7. Mungesa e menaxhimit të energjisë: Ushqyerja dhe gjumi duket se janë fatkeqësia e parë gjatë Ramazanit – ne nuk ushqehemi siç duhet, nuk flemë siç duhet, prandaj nuk mund të funksionojmë siç duhet dhe biem në rrugëtimin e gabuar nëpër Ramazan!

8. Mungesa e fitnesit: “A mos je çmendur?! Fitnes në Ramazan?! Shoku, nga cili planet vini?...” Jo, nuk jam i çmendur. Fitnesi është shumë i mundshëm në Ramazan, madje, do të sjell edhe argumente se është gjithashtu mjaft i rëndësishëm.

9. Mungesa e lidhjes shpirtërore: Ah, thelbi i Ramazanit - zhvillimi i aspektit tonë shpirtëror dhe frikë-respektit ndaj Allahut të Lartësuar. Disi po harrojmë se Ramazani është një kohë për ripërtëritje shpirtërore. Po e humbasim veten në gjysmë të rrugës së Ramazanit dhe, veç kur po shohim se kemi rrëshqitur sërish në rrugëtimin e gabuar nëpër Ramazan.

10. Mungesa e trajnimit: Ne nuk duhet të planifikojmë për Ramazan, por duhet të trajnohemi për Ramazan. Ramazani është arena e besimtarëve, një shans për të bërë më të mirën tonë dhe për të korrur përfitime. Por ka nevojë për trajnim gjatë gjithë vitit.

Siç do t’ju thoshte çdo atlet olimpik: ju duhet të trajnoheni për garën e madhe dhe jo vetëm të paraqiteni në ditën e ngjarjes dhe të prisni të fitoni!

Jam i vetëdijshëm se po flas në përgjithësi dhe ndoshta dhjetë arsyet e mësipërme për të rënë në një rrugëtim të gabuar nëpër Ramazan nuk vlejnë për ju, por dua që ju të hulumtoni nëpër kujtimet dhe përvojat tuaja të Ramazanit dhe të pyesni veten nëse ndonjëra nga 10 arsyet e mësipërme, në fakt, është shkaku kryesor që të përjetosh një “Ramazan joproduktiv”.

Lajmi i mirë

Sigurisht se kemi lajm të mirë! Nëse ndonjë nga ato që u thanë më sipër qëllon të jetë e vërtetë për ju, nuk jeni i vetmi!

Miliona muslimanë në mbarë botën përballen me këto kurthe dhe kanë probleme me to çdo Ramazan. Kemi marrë aq shumë e-maile nga lexuesit anembanë botës që ankohen për mungesën e produktivitetit të tyre gjatë Ramazanit dhe se nuk e shfrytëzojnë maksimalisht muajin e veçantë e të bekuar. Pra, nuk jeni vetëm, dhe ka një zgjidhje.

Kthehu pak prapa...

Unë dua që ne të tërhiqemi pak më vete dhe të mendojmë, pse po flasim për një gjë të tillë? Cila është çështja e madhe, pse thjesht duhet ta kemi një Ramazan tjetër nga ai i "modalitetit të mbijetesës" dhe thjesht të shpresojmë për më të mirën e ahiretit tonë?

Imagjinoni që po ju jepet një muaj për ta kaluar në një minierë ari për të përfituar sado që t'i dëshiron dhe ke mundësi dhe në fund të muajit gjithçka që arrini të nxirrni është bakri. A nuk do të ndiheni të zhgënjyer, ndoshta edhe budallenj? Kjo është metafora për ata që hyn dhe dalin nga Ramazani dhe prej tij marrin shumë pak.

Ramazani është plot me pasuri të jashtëzakonshme shpirtërore, arka të thesarit të punëve të mira dhe shpërblime që na janë dhënë në një pjatë të artë dhe gjithçka që kërkohet është një përpjekje nga ana jonë. Në fakt, Allahu (Subhanehu ue teala) na e bëri kaq të lehtë saqë i mbylli ata shejtanët e bezdisshëm, të çmendur e të këqij, që të mos na bëjnë pëshpëritjet e tyre të bezdisshme në veshët tanë dhe të na pengojnë që ta shfrytëzojmë sa më shumë Ramazanin... çfarë duam më shumë?!

Gjithashtu, le të shohim pamjen e përgjithshme dhe të mendojmë në nivelin e umetit në tërësi: si Umet, a jemi të kënaqur me mënyrën se si po e shfrytëzojmë Ramazanin? Për të qenë i sinqertë, është pak e turpshme mënyra se si jemi ne muslimanët gjatë Ramazanit: bëhemi joproduktivë dhe dembelë, dyqanet dhe bizneset tona praktikisht ndalojnë ditën dhe çmenden natën.

Ramazani është keqkuptuar si muaji i blerjeve të natës dhe i gjumit gjatë ditës, dhe me të vërtetë ne kemi abuzuar me mesazhin e këtij muaji të bekuar, kështu që edhe jomuslimanët filluan të kenë përshtypje negative për muajin e Ramazanit, një formë kjo jo shumë e mirë e davetit. Allahu (Subhanehu ue teala) na faltë.

Më tepër për këtë projekt

E vërteta është, vëllezër dhe motra, se ne duhet të rimendojmë seriozisht mënyrën se si po e kalojmë Ramazanin tonë dhe duhet të bëjmë disa përpjekje serioze për të pasur një Ramazan produktiv – si në nivel individual ashtu edhe në nivel të komunitetit (umetit).

Ne duhet të ndërtojmë një sistem dhe komunitet që na përgatit, na trajnon dhe na mbështet të gjithëve për të pasur një Ramazan të plotë dhe produktiv. Ky sistem duhet të na ndihmojë të përfshijmë 7 pikat praktike të mëposhtme:

1. Të kuptojmë parimet e: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe Vetëm prej Teje kërkojmë Ndhimë!”
2. Si t'i menaxhojmë energjitë tona për të shfrytëzuar sa më shumë Ramazanin dhe të mos ndihemi të lodhur.
3. Si të përqendrohemi në punë, shkollë apo shtëpi gjatë agjërimit.
4. Si ta menaxhojmë gjumin gjatë Ramazanit për të shfrytëzuar sa më shumë muajin.
5. Si të zhvillohemi shpirtërisht gjatë Ramazanit.

6. Si të përdorim fitnesin për të na ndihmuar të qëndrojmë të mprehtë gjatë Ramazanit.

7. Si ta menaxhojmë kohën në mënyrë efektive në muajin e bekuar.

Këtu hyn në punë ProductiveRamadan.com, i cili është këtu që ju të zbuloni se si t'i bëni të gjitha 7 pikat e mësipërme, madje edhe më shumë, përmes materialeve, e-maileve dhe këtij e-Libri falas, i cili përmban 30 këshilla ose mesazhe të produktivitetit për t'ju ndihmuar të shfrytëzoni sa më shumë çdo ditë të Ramazanit.

Si ta përdorni këtë libër

Ky libër duhet të jetë pjesë e rutinës suaj të përditshme gjatë Ramazanit. Lexoni mesazhin e ditës dhe më pas kaloni 10-15 minuta me fletën tonë të famshme “Planifikuesi Ramazanor” për të planifikuar për veten tuaj atë ditë të Ramazanit.

Nëse faqja jonë e internetit ProductiveRamadan.com dhe të gjitha këshillat në këtë e-Libër nuk janë të mjaftueshme për t'ju ndihmuar të përfitoni sa më shumë nga Ramazani, ose nëse thjesht dëshironi të zbuloni sekretet e një jete produktive gjatë Ramazanit, ju mirëpresim të bashkoheni në kursin tonë online, ku do mësojmë këshilla, teknika dhe ide për të pasur një Ramazan vërtet produktiv, Insha'Allah!

Për më shumë informacion, vizitoni
www.ProductiveRamadan.com/onlinecourse

Në emër të ekipit Produktiv Musliman, ju uroj një Ramazan vërtet të bekuar dhe produktiv!
Singerisht,

vëllai juaj në Islam,

Ebu Productive
Themeluesi & CEO - ProductiveMuslim.com,
ProductiveRamadan.com



DITA 1


Udhëtimi fillon këtu - Bismillah!

Më në fund erdhi... muaji i bekuar i Ramazanit!

Këshillat e sotme:

- Pastrojeni njetin për agjërim. Sigurohuni që të jetë singërisht për Allahun.
- Vendosni alarme të shumta për një syfyr sa më të vonshëm që të jetë e mundur – assesi të mos na humbasë!
- Rezervoni një ose dy periudha 30-minutëshe të recitimit të Kuranit çdo ditë (pastaj mund të shtoni më shumë periudha, por këto duhet të jenë minimumi juaj për një ditë).

Për më shumë këshilla se si të jeni produktiv gjatë Ramazanit, shikoni skicën tonë me 10 këshillat kryesore për një Ramazanin produktiv.



DITA 2

Ju kujtohet Ramazani i kaluar?

Si ishte? Ishte produktiv, apo mezi mbijetuat?

Nëse keni pasur një Ramazan joproduktiv vitin e kaluar, mos e përsëritni këtë vit. Ndjenja e fajit për Ramazanin e vitit të kaluar nuk do t'ju sjellë dobi nëse nuk mund ta përdorni atë faj për të ndezur një dëshirë të zjarrtë tek ju SOT për të bërë më shumë këtë vit, për të përmirësuar veten dhe për të mos rënë në të njëjtat gracka si vitin e kaluar.

Në anën tjetër, nëse keni pasur një Ramazan super-produktiv vitin e kaluar, elhamdulillah!, përpiquni të kujtoni se çfarë funksionoi për ju vitin e kaluar dhe si mund të përmirësoheni edhe më.



DITA 3

A je i angazhuar, madje joproduktiv?

Sa herë që mendojmë për “njerëzit joproduktivë” gjatë Ramazanit, mendojmë për njerëzit që humbin kohën duke qëndruar zgjuar gjithë natën duke parë TV dhe duke fjetur tërë ditën deri në Ikindi (ose ndonjëherë deri në Akshami)!

Por ka një lloj tjetër personi joproduktiv gjatë Ramazanit:

Janë ata adhuruesit e punës – ata që mezi kanë kohë për të adhuruar Allahun e Lartësuar gjatë Ramazanit, sepse janë kaq të zënë me jetën/punën/familjen dhe gjithçka tjetër në të cilën janë zhytur. Ata gjithashtu nuk ndajnë kohë për të lexuar Kuran, mezi japin ndonjë sadaka dhe namazin e teravive thjesht nuk bëhet fjalë ta falin ndonjëherë!

Ju mund të polemizoni se kjo nuk është aq e keqe - të paktën ata janë “produktiv”. Por, a janë në të vërtetë të këtillë?! Apo thjesht janë që e harxhojnë Ramazanin kot?

Në panoramën e madhe të gjërave, nëse ata vdesin sot, a do t'u sjellë dobi gjithë ky “angazhim” i tyre, apo mos do të jetë një “dështim”?

Ne duhet të jemi të kujdesshëm ndaj këtij lloji të dytë të sjelljes joproduktive. Na prek të gjithëve, veçanërisht ata me orare të ngarkuara. Ramazani mund të rrëshqasë lehtësisht nga ne për shkak të stilit tonë të ngjeshur të jetesës dhe ne do të ndjejmë keqardhje vetëm në ditën e fundit të Ramazanit. Pra, le të mos ndjejmë këtë keqardhje këtë vit!



DITA 4

Koha për një rishikim ditor!

Kaloni 10-15 minutat e fundit të çdo dite të Ramazanit duke rishikuar ditën tuaj. (Ky mund të jetë një praktikë e thjeshtë mendore ose e shkruar).

Nëse dita juaj ishte produktive, pyesni veten se çfarë shkoi mirë. Cilët ishin përbërësit që e bënë produktive këtë ditë? Si mund ta përsëris këtë përvojë çdo ditë?

Mos harroni të falënderoni Allahun e Lartësuar që ju bekoi me një ditë produktive.

E, nëse nuk ishte produktive, pyesni veten se çfarë shkoi keq. Si mund ta shmang përsëritjen e një dite të tillë gjatë Ramazanit? Kërkojini Allahut të Lartësuar t'ju ndihmojë t'i bëni ditët tuaja të ardhshme produktive.

Rinovoni synimin tuaj dhe jini pozitiv se, nëse ju jepet jeta, e nesërmja do të jetë më e mirë.

Ju duhet të dëshironi që vazhdimisht të jeni në zhvillim dhe përmirësim për çdo ditë të Ramazanit, në mënyrë që në 10 ditët e fundit të jeni në kulmin tuaj, në dashtë Allahu!



DITA 5

Produktivitet për hir të...?

“Thuaj: “Namazi im, kurban i im dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve.” (Surja En’am, 162).

Prandaj, produktiviteti dhe përpjekjet tona duhet t'i drejtohen Atij dhe gjërave me të cilat Ai është i kënaqur.

Ndonjëherë ne thjesht kryejmë veprime për hir të kryerjes së tyre, pa i llogaritur nijetet (qëllimet) pas tyre, ndonëse e dimë mirë se veprimet tona vlerësohen sipas qëllimit.

Herën tjetër që do të filloni ndonjë aktivitet produktiv, pyeteni veten: “A është kjo për Allahun e Lartësuar apo jo?”



DITA 6

Çfarë ke në mendje?

Në betejën tonë të përditshme për të qëndruar vazhdimisht produktiv gjatë Ramazanit, është e lehtë të bëhesh i fiksuar pas disa çështjeve të produktivitetit fizik si: sa ore kam fjetur? Sa kalori kam konsumuar? A ushtrova? Etj.

Kjo është e rëndësishme, por mbani mend se produktiviteti fizik është vetëm një mjet dhe jo vetë qëllimi final.

Në përkufizimin tonë si Muslimanë Produktiv, produktiviteti fizik ka të bëjë me optimizimin e aftësive tuaja fizike për t'ju mundësuar t'i shërbeni më mirë Allahut të Lartësuar dhe ta adhuronit më mirë Atë.

Ajo që duhet t'ju shqetësojë është:

- A do ta pranojë Allahu i Lartësuar agjërimin tim?
- A jam falur me kohë dhe me të gjitha sunetet (përcjellëse)?
- A kam lexuar Kuran?

Mos harroni, Ramazani nuk ka të bëjë vetëm me arritjen me kohë në tryezën e iftarit në fund të ditës, por, synon arritjen e një niveli të ri shpirtëror me Allahun përmes veprave tuaja.



DITA 7

Kur do të bëhesh produktiv?

Sot kemi një thirrje përfundimtare për të gjithë ata që ende nuk kanë hyrë në turmën e atyre që janë bërë produktiv për hir të Tij, për të na u bashkuar në udhëtimin tonë.

Nëse nuk vendosni të bëheni produktivë këtë Ramazan, atëherë kur tjetër do të bëheni produktiv?

E nëse tashmë veç jeni produktiv, atëherë, a është ky produktivitet i juaji sinqerisht për hir të Tij?

Këtë Ramazan ne duam të sigurohemi që të keni një Ramazan "pa gabime", pa keqardhje, në mënyrë që të përfitoni nga kjo mundësi!



DITA 8

Fillo me syfyr

Kur duhet ta filloni ditën tuaj gjatë Ramazanit? A duhet të filloni herët (pra të keni një ditë më të gjatë agjërimi) apo duhet të flini sa më shumë, derisa të mos keni tjetër zgjidhje përveçse të zgjoheni?

Këshilla ime: dita juaj produktive duhet të fillojë menjëherë pas syfyr (jo, nuk po bëj shaka!) Provojeni këtë sonte/nesër dhe shikoni se si ndiheni:

Flini sa më herët që të mundeni (idealisht pas taravive).

Pastaj zgjohuni një orë para sabahut dhe hani syfyr të shëndetshëm. Relaksohuni pas ngrënies, falni sabahun, lexoni pak Kuran dhe më pas filloni punën e ditës suaj.

Kryeni një deri në tri detyrat më të rëndësishme të ditës; këto mund të jenë të lidhura me punën ose familjen.

Sido që të jetë, sigurohuni që:

- Nuk ka asgjë më të rëndësishme se këto detyra dhe
- t'i kryeni ato dhe të mos shpërqendroheni.

Siç transmetohet në shumë hadithe, syfyri është një bekim - prandaj mos e humbisni. Filloni ditën tuaj me të!



DITA 9

Fillo me syfyr (vazhdim)

Më poshtë janë përgjigjet e pyetjeve të zakonshme në lidhje me këtë teknikë:

P. Çfarë të keqe ka të flesh pas syfyrit?

Përgjigje: Nëse keni pyetur ndonjëherë veten pse ditët tuaja të Ramazanit janë kaq të lodhshme dhe pse jeni gjithmonë të lodhur/pa humor në punë/shkollë, kjo mund të jetë përgjigja juaj. Provoni të qëndroni zgjuar pas syfyrit për disa ditë dhe do të vini re ndryshimin në qëndrimin tuaj dhe nivelet e produktivitetit.

P. Mos do të thuash që nuk duhet të fle prej syfyrit e deri në natën e ardhshme?!

Përgjigje: Sigurisht që jo! Kjo do të ishte vrasëse! Ajo që kam për qëllim është që të qëndroni zgjuar për të paktën 3 orë pas syfyrit për të falur namazin e sabahut, për të lexuar Kuran dhe për të kryer 1-3 detyra të rëndësishme të ditës suaj. Pas kësaj, ju "lejoheni" të flini ose të bëni një sy gjumë për t'u përgatitur para punës/shkollës ose ta shtyni gjumin pak para ose pas Drekës.



DITA 10

Oh jo, më paska ikur syfyri!

Këtu janë 6 këshilla të shpejta nëse ju ka ikur syfyri dhe dëshironi të qëndroni produktiv:

1. Mos u frikësoni: qetësohuni, falni sabahun, lexoni pak Kuran. Do të jesh mirë!

2. Mos u fiksoni pas kësaj: Mos ia kujtoni vetes vazhdimisht gjatë ditës se keni humbur syfyrin, se keni ngrënë vetëm një vakt mbrëmë, etj. Mjafton vetëm të kesh këto mendime për të harxhuar energjinë tuaj dhe për t'ju dhënë një justifikim për të qenë joproduktiv.

3. Vazhdoni me ditën tuaj: Një atlet dikur tha: "Nuk ka asgjë më të fuqishme se një mendje e krijuar". Vendosni mendjen tuaj të jeni produktiv, flisni me veten si një atlet dhe vazhdoni me ditën tuaj!

4. Dremitni nëse keni nevojë: Nëse ndiheni shumë të uritur, atëherë dremitni/bëni pushime të shkurtra, për të ndihmuar veten të kaloni ditën.

5. Mbani veten të zënë: A keni pasur ndonjëherë një nga ato ditë të Ramazanit që ka kaluar kaq shpejt? Shanset janë që ju e keni kaluar atë ditë, ose shumë të zënë, ose duke bërë diçka që ju ka pëlqyer vërtet. Përpiquni të bëni të njëjtën gjë këtu dhe nuk do të ndjeni se keni humbur fare syfyrin, në dashtë Allahu.

6. Lute Allahun e Lartësuar që t'ju ndihmojë gjatë asaj dite. Kujto ajetin: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe prej vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!”** (El-Fatiha. 1:5). Nëse agjërojmë për Allahun, atëherë le t'i kërkojmë Atij që të na ndihmojë në agjërimin tonë, që ta kryejmë atë si duhet, pavarësisht se a e kemi humbur syfyrin apo jo.

PRODUCTIVE
RAMADAN.com 

 Literatura
ISLAME

DITA 11

Koha për një kuiz të çastit!

Duke qenë se një e treta e këtij muaji kaloj, le të rishikojmë përparimin tuaj.

- Sa ditë në 10 ditët e fundit keni arritur të zgjoheni për syfyr pak para sabahut?
- Sa ditë në 10 ditët e fundit keni arritur të qëndroni zgjuar pas sabahut dhe keni bërë disa punë të rëndësishme në orët e hershme të mëngjesit?

Jepini vetes një pikë për çdo ditë që keni pasur sukses. Sa më lartë që të keni korrur sukses, aq më i madh është treguesi se tashmë po kaloni një Ramazan produktiv!

Këta dy përbërës janë çelësi për të pasur një Ramazan produktiv:

- Të kesh syfyr sa më afër sabahut, gjë që siguron që të kesh sasinë e duhur të energjisë për të vazhduar pjesën tjetër të ditës.
- Të qëndrosh zgjuar pas sabahut, që do të thotë se po përfiton nga duaja e Profetit Muhamed (paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të!) në të cilën tha: **“O Allah, bekoje umetin tim në orët e hershme të tij!” pra, kështu ti je duke bërë më shumë punë në krahasim me ata që flenë deri në Drekë (ose Ikindi)!**

Nëse keni marrë rezultate të ulëta në kuizin e mësipërm, është koha të rivlerësoni produktivitetin tuaj dhe menaxhimin e kohës gjatë Ramazanit. Na ndajnë më pak se 20 ditë nga Bajrami! Le të shfrytëzojmë pjesën më të madhe të kohës që na ka mbetur.

DITA 12

Në cilin nivel je?

Ndërsa po i afrohemi mesit të Ramazanit, ne duhet të vlerësojmë veten në aspektin e produktivitetit shpirtëror, produktivitetit fizik dhe produktivitetit social.

Zakonisht njerëzit mund të ndahen në 3 kategori në lidhje me kohën e shfrytëzuar:

Kategoria 1: Ata që filluan mirë dhe vazhdojnë të jenë të suksesshëm. Këta janë startuesit e fuqishëm dhe ata që çdo ditë e shtyjnë veten për ta shfrytëzuar Ramazanin sa më mirë!

Kategoria 2: Ata që filluan mirë, por ngadalë, fillojnë të rrëshqasin në veprat e tyre të mira. Këta janë njerëzit që patën një fillim të mrekullueshëm e të fortë, por shpejt ata u relaksuan dhe vetëm kur panë se oraret e tyre janë prishur.

Kategoria 3: Ata që kishin një fillim të keq dhe nuk janë të sigurt se çfarë duhet të bëjnë për ta kompensuar atë që u ka ikur.

Për ju të Kategorisë 1 - Allahu i Lartësuar ju mbajttë të palëkundur! Vazhdoni punën e mirë dhe mos e lini kurrë! Siç është transmetuar në hadith se Allahu i do veprat e mira që bëhen në vazhdimësi.

Për ju të Kategorisë 2 - mos u frikësoni! Rishikoni se çfarë duhet të ndryshojë në jetën tuaj në mënyrë që të mund të ktheheni në rrugën e duhur dhe t'i vendosni vetes një objektiv për të bërë më mirë në 10 ditët e ardhshme. Mos e humbni shpresën; Pjesa më e mirë e këtij muaji nuk ka ardhur ende Insha Allah!

Për ju të Kategorisë 3 - ju duhet të ndryshoni qysh SOT! Çohu tani, merr abdes, fal 2 rekate për Allahun e Lartësuar dhe lute Atë që të të ndihmojë të shfrytëzosh sa më mirë Ramazanin. E, nëse vazhdoni ashtu siç jeni, do të arrini në fund të Ramazanit duke ndjerë keqardhje, në kohën kur do të jetë tepër vonë dhe nuk do të keni askënd për të fajësuar përveç vetes.

DITA 13


Nuk po ndihesh se je produktiv?

Një nga plagët më të mëdha të produktivitetit është paqëndrueshmëria. Nëse kohëve të fundit po ju vie rëndë të kapni kopjen e Kuranit dhe të lexoni një Xhuz, ose të ngriheni për 8 deri në 20 rekate të tjera për teravitë pas jacisë, ose ndonjë vepër tjetër të mirë që keni bërë në fillim të Ramazanit, para se ta lëshoni atë, atëherë ne kemi një këshillë të thjeshtë dhe praktike për ju:

VETËM NGRIHUNI DHE BËJENI!

Hidhni një hap të vogël drejt veprës së mirë dhe do të gjeni veten një milje përpara pa e kuptuar fare, Insha Allah. Thjesht kape atë Kuran dhe lexoje. Thjesht ngrihu dhe fali ato 2 rekate, pastaj tjetrin dhe tjetrin. Thjesht mësyja shoqatës bamirëse që e ke në lagje dhe jep vullnetarisht kohën tënde në mënyrë që të jeni të rrethuar nga njerëz të tjerë që bëjnë vepra të mira.

Sapo të viheni në lëvizje, zemra dhe mendja juaj do t'ju ndjekin. Vetëm duhet të bëni atë hapin e parë!



DITA 14

Po të mungon ajo ndjenja?

Pasi të jeni në gjendje të kapërceni barrierën “fizike” duke bërë veprën e mirë, është koha për të kapërcyer edhe pengesën mendore. Pyete veten:

- A paska qenë vërtetë kaq vështirë ta bëja përsëri (veprën e mirë) dhe ta bëja hapin e parë?
- Çfarë më ndalonte më parë?
- Si mund ta shmang këtë ndjenjën e “mos të ndjehem i gatshëm” për t'i bërë këto vepra të mira herë pas here?

Ne nuk do t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve për ju: ne duam që ju t'u përgjigjeni atyre.

Mund t'ju mungojë ajo ndjesia që keni pasur në fillim të Ramazanit, megjithatë nuk duhet të jeni të varur me mendimin se thjesht nuk dëshironi ta bëni atë.



DITA 15

A e ke goditur cakun e gjysmës së rrugës?

Këtu janë përgjigjet për disa pyetje të bëra shpesh:

P. Si mund ta dalloni se jeni i lodhur fizikisht kundrejt të qenit thjesht dembel?

Përgjigja: Shumë lehtë mund të ndodh që dembelizmi ynë të maskohet si lodhje fizike. Qëndrojmë në teravi dhe këmbët na dridhen, ose lexojmë Kuran dhe qepallat veç sa s'na mbyllen, por në momentin që dalim nga xhamia ose mbyllim Kuranin, befas ndihemi shumë energjikë! Duhet të jemi të kujdesshëm ndaj kësaj, të kapim veten dhe ta qortojmë kur kuptojmë se nuk jemi të lodhur, por thjesht jemi dembelë.

Përpiquni të gjeni shkakun rrënjësor të këtij dembelizmi: është mungesë sinqeriteti? Iman i ulët? Një mëkat që keni bërë që po ju pengon të shijoni veprën e mirë? Bëj dua që Allahu i Lartësuar ta largojë këtë dembelizëm prej teje. Ju nuk dëshironi që ai t'ju prishë Ramazanin.

Megjithatë, nëse trupi juaj vërtet dhemb dhe nuk keni fjetur siç duhet për ditë të tëra, atëherë jeni të lodhur fizikisht dhe duhet të pushoni urgjentisht.

P. Si mund të kapërcehet mendimi: "më lejoni ta kapërcej këtë vepër të mirë kësaj radhe, do ta bëj më vonë"?

Përgjigja: "Tesuifi" - ose fjala arabe "seufe" - që do të thotë "do ta bëj!" - është një mashtrim i zakonshëm i shejtanit. Në fakt, ky është një nga truqet e tij më të mira. Tingëllon shumë mirë të vonosh një vepër të mirë derisa të arrijë koha "perfekte" për të; POR koha e përsosur nuk do të vijë kurrë. Koha perfekte është TANI!

Mos harroni gjithashtu se çdo ditë e Ramazanit që kalon pa bërë sa më shumë vepra të mira që mundeni është një ditë që ka ikur përgjithmonë dhe nuk do ta shihni më kurrë deri në Ditën e Gjykimit. Pra, si dëshironi t'i shihni ditët tuaja të Ramazanit në Ditën e Gjykimit? Plot me vepra të mira apo me zbrazëtira, ngaqë vazhduat të "kapërceni" veprat e mira?

Nëse keni ardhur në gjysmë të këtij muaji të bekuar, mos i lini t'ju rrëshqasin veprat e mira; në vend të kësaj, investoni në ato pak ditë që kanë mbetur.

DITA 16

Suksesi vjen vetëm prej Allahut

Pikërisht në këtë ditë, mbi 1400 vjet më parë, u zhvillua beteja e madhe e Bedrit. Të gjithë e dimë historinë e saj dhe se si Allahu i Lartësuar i dha fitore Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe shokëve të tij (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) atë ditë. Por çfarë mësimesh mund të nxjerrim nga kjo betejë që lidhet me produktivitetin tonë? Ja një:

Pasi u fitua beteja, Allahu i Lartësuar shpalli ajetin vijues: **“Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur qetë të pafuqishëm, andaj frikësojuni Allahut, për të qenë falënderues.” (Ali Imran, 123).**

Kjo ishte një përkujtim për muslimanët se çdo sukses apo fitore është nga Allahu dhe vetëm nga Allahu. Andaj, nuk duhet të jenë arrogantë dhe të harrojnë burimin e suksesit të tyre. Ndonjëherë kur jeni super produktiv dhe arrini shumë brenda një dite, është e lehtë të supozoni se suksesi juaj vjen nga aftësitë ose njohuritë tuaja, por muslimani nuk mendon kështu. Një musliman beson me vendosmëri në ajetin se **“Ndërsa suksesi im varet vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem.” (Hud, 88).**

Më në fund, në këtë ditë të veçantë, bëni dua për vëllezërit dhe motrat tona të shtypura në shumë vende të botës. Ata po kalojnë një Ramazan të vështirë dhe më e pakta që mund të bëjmë për ta është të lutemi. E lusim Allahun e Lartësuar, me Mundësinë dhe Fuqinë e Tij, Atë që i dha fitoren Pejgamberit të Tij në ditën e Bedrit, që t'u japë vëllezërve dhe motrave tona fitore ndaj shtypësve dhe të gjithë atyre që u bëjnë keq atyre. Amin!

DITA 17

Cila është dita jote ideale e Ramazanit?

Së shpejti do të fillojnë 10 netët e fundit të Ramazanit. Kjo është koha që do të na duhet për të mbledhur së bashku të gjitha energjitë tona dhe të gjitha teknikat tona të produktivitetit për t'u siguruar që të investojmë në çdo moment të këtyre 10 netëve të fundit, sa më mirë që kemi mundësi.

Sot ju ftojmë që të shkarkoni edhe Planifikuesin tonë (“Ramadan Taskinator”) dhe të filloni duke planifikuar 10 ditët tuaja të fundit, orë pas ore.

Pyete veten: “Nëse do ta dija se cila natë nga 10 netët është Nata e Kadrit, si do ta kaloja atë natë?” Pastaj përsërisni atë natë ideale gjatë 10 netëve, ose të paktën në netët tek.

Më produktivi prej jush, le të fitojë shpërblimet më të larta në këto netë të fundit dhe shpërblimin e Natës së Kadrit! Amin.



DITA 18

A je gjatë namazit si ai burri i moshuar?

Dy vjet më parë, fala teravitë pranë një burri shumë të moshuar. Vura re se ai mezi çohet dhe mezi ngrihet në këmbë (duke u dridhur nga dobësia), por megjithatë u ngrit në këmbë për gjithë namazin e jacisë dhe të teravive. Dikush mund t'i kishte thënë të ulej dhe të pushonte, por nga vendosmëria e tij në çdo rekat mund të dallos se ai dëshironte të ngrihet për Allahun e Lartësuar gjatë Ramazanit dhe nuk donte të ulej.

Plaku më kujtoi se ndonjëherë vlerësimi i asaj se sa shumë e do dikë është se sa përpjekje je i gatshëm të bësh për të. Nëse vërtet e duam Allahun e Lartësuar, a nuk duhet të gjithë ne të bëjmë atë pak përpjekje shtesë për Të?

Mendo për një lëmi ose aktivitet ku do t'i tregosh Allahut të Lartësuar se po bën atë pak përpjekje shtesë për Të. Mund të jetë kjo zgjimi për namaz të natës ose falja e atyre namazeve shtesë sunet, ose dalja për të ushqyer njerëzit.



DITA 19

I zënë gjatë 10 netëve të fundit?

Nëse mendojmë për qëllimin tonë në jetë dhe destinacionin tonë përfundimtar, Xhenetin, përgjigja bëhet shumë e lehtë: sakrifikoni punën e ditëve tuaja për 10 ditë, në mënyrë që të mund të përqendroheshi në adhurimin e natës. Megjithatë, jo të gjithë mund ta bëjnë këtë. Pra, çfarë mund të bëni? Këtu janë disa këshilla:

- Përdorni një menaxhim të mirë të detyrave dhe kohës për të qenë në gjendje të ekuilibroni midis punës dhe adhurimit. Shikoni Planifikuesin e Ramazanit.
- Planifikoni ditën tuaj orë pas ore dhe shikoni se në cilat hapësira duhet të jeni në punë, në cilat hapësira duhet të jeni në xhami, dhe çfarë duhet të bëni me hapësirat mes tyre për të maksimizuar energjinë/kohën tuaj. (p.sh. dremitje përforcuese, iftar i lehtë, etj.)
- Jini të pamëshirshëm në disiplinën tuaj kohore dhe sigurohuni që asnjë minutë të mos humbet kot. Përndryshe, kjo do të ketë efekt në pjesën tjetër të ditës suaj. Mos jini të vetëkënaqur kur i mbaroni me sukses aktivitetet që konsumojnë kohë, përkundrazi, futeni veten në modalitetin e "gatishmërisë së lartë".

Ndiqni disiplinën e mësipërme si orar për të paktën 10 netët e fundit dhe do të jeni mirë, Insha Allah!



DITA 20

Mënyra natyrale për të qëndruar zgjuar

Për njerëzit që janë të zënë me punë gjatë ditës, mund të jetë një sfidë ekstreme të shfrytëzojnë sa më shumë 10 netët e fundit për ibadet, dhe disa madje mund të përdorin mënyra të panatyrshme për të qëndruar zgjuar, duke përfshirë konsumimin e sasive të mëdha të kafeinës, e cila mund të jetë e dëmshme për shëndetin e dikujt.

Këtu janë disa mënyra natyrale për të qëndruar zgjuar natën Insha Allah:

- Dremitja: Mësoni të bëni dremitje të shkurtra që ju japin forcë. Këto mund të sillen prej 20 deri në 40 minuta, e maksimum deri në 90 minuta. Ato janë jashtëzakonisht të fuqishme për t'ju mbajtur zgjuar dhe për t'ju mbajtur në formë për të paktën 3-4 orë pas gjumit. Sa herë që jeni të lodhur dhe shihni një dritare mundësie për të një dremitje të shpejtë - bëjeni këtë. Kjo do t'ju ndihmojë të vazhdoni insha Allah.

- Ushqimi: Ajo që hamë ndikon nëse do të mund të qëndrojmë zgjuar apo do të flemë. Sa më shumë të hamë në iftar/syfyr, aq më shumë do të ndihemi të përgjumur. Hani më lehtë dhe më shëndetshëm për këto 10 netë dhe do të mund t'i kryeni me lehtësi namazet e gjata të natës Insha Allah.

- Bëni dua që Allahu t'ju bekojë me energji, të bekojë gjumin tuaj dhe të bekojë kohën tuaj, në mënyrë që të mund të përfitoni sa më shumë nga këto netë të bekuara dhe të arrini produktivitetin maksimal në to, insha Allah.

PRODUCTIVE
RAMADAN.com 

 Literatura
ISLAME

DITA 21

Cila do të jetë një vepër e mirë SPECIALE e jotja?

Cila është një vepër e mirë e veçantë me të cilën do të dëshironit të kujtonit Ramazanin tuaj të këtij viti, në mënyrë që të mos jeni penduar deri në fund të tij? Diçka që nuk e keni bërë kurrë më parë, diçka që e keni shtyrë veten përtej mundësive tuaja dhe jashtë zonës suaj të rehatisë për ta arritur!?

Këtu janë disa ide:

- Shkoni në një itikaf të plotë 10-ditor (ose më pak, nëse kjo është hera juaj e parë ose nëse angazhimet nuk ju lejojnë)
- Nxirrni kuletën dhe jepni donacionin më të madh që keni dhënë ndonjëherë në jetën tuaj për një qëllim bamirësie.
- Falni atë personin për të cilin thatë se nuk do ta falnit kurrë.
- Njihuni me një familje të varfër dhe betohuni se do t'i sponsorizoni ato sa të jeni gjallë.
- Organizoni një iftar në një jetimore.
- Dhurojini Allahut të Lartësuar një pjesë të rëndësishme të pasurisë që keni (p.sh. tokë/pronë/fermë) në formën e vakëfit.

Bëjeni këtë Ramazan vërtet të paharrueshëm për shpirtin tuaj duke bërë diçka të jashtëzakonshme këtë Ramazan! Mendoni për këtë dhe mësyjani!

PRODUCTIVE
RAMADAN.COM 

 Literatura
ISLAME

DITA 22

Cila do të jetë NJË vepër e mirë e jotja? (pjesa e dytë)

Sot, mendoni për NJË vepër të mirë që i premtoni vetes se do të vazhdoni ta bëni edhe pas Ramazanit. Cili do të jetë ajo?

A do të jetë falja e namazit të natës çdo natë, prej tani e tutje?

A do të jetë agjërim çdo të hënë dhe të enjte, apo të paktën 3 ditë të muajit çdo muaj?

A do të jetë falja në xhami për çdo namaz?

A do të jetë leximi i një xhuzi të Kuranit çdo ditë?

A do të jetë dhënia sadaka vazhdimisht, të paktën një herë në javë?

Çfarë do të ketë për ty si shpërblim?

Mbani mend: “Veprat më të dashura për Allahun janë ato që bëhen në vazhdimësi, edhe nëse janë pak.” (Buhariu).

Këto vepra të mira duhet të jenë pjesë e jetës suaj edhe pas Ramazanit – kështu që zgjidhni njërën prej tyre dhe shkruajeni, dhe pas Ramazanit, kontrolloni veten për t'u siguruar që ta kryeni vazhdimisht këtë vepër të mirë.

“Formuesi i shprehive” (Habitator) i ProductiveMuslim-it është një mjet i shkëlqyer për t'ju ndihmuar me këtë, Insha Allah!



DITA 23

A je i lodhur por i lumtur?

Nëse keni vazhduar të qëndroni me një Ramazan produktiv, duke bërë çmos për të balancuar produktivitetin shpirtëror, social dhe fizik, ndoshta do të jeni pak të lodhur tani.

Por sinqerisht, a nuk jeni të lumtur që po kaloni një Ramazan produktiv dhe me shpresë se Allahu i Lartësuar do ta pranojë atë? Imagjinoni sikur të kishit fjetur gjithë ditën gjatë Ramazanit apo sikur të kishit qëndruar gjithë natën duke u argëtuar me miqtë dhe duke parë filma. A do të ishit të lumtur?

Lumturia dhe dëshpërimi ynë janë të lidhura me atë se sa afër jemi me Allahun e Lartësuar. Si qenie njerëzore, ne në thelb ndihemi të lumtur kur adhurojmë Allahun e Lartësuar, pavarësisht se sa të lodhur jemi. Kësisoj, ne jemi “të programuar” që, kur jemi larg Allahut, të ndjehemi të dëshpëruar, pavarësisht sa të relaksuar jemi fizikisht.

Pra, nëse ndiheni pak të lodhur dhe të rraskapitur këto ditë, ndjehuni të lumtur që po bëni më të mirën, buzëqeshni dhe luteni Allahun që t’ju ndihmojë të vazhdoni në rrugën e Tij!



DITA 24

Ballë-për-ballë me zemrën tënde

Nëse jeni duke qëndruar në këto ditët e fundit të Ramazanit, duke bërë më të mirën tuaj për t'u ndier më afër Allahut të Lartësuar, por në njëfarë mënyre po ndiheni të distancuar; nëse po e pyesni veten pse të gjithë ata rreth jush qajnë si foshnja ndërsa ju jeni pa emocione; Nëse dëshironi të jeni nga ata me zemra të buta dhe sy të përplotur në Ramazan, por një gjë e tillë nuk po ju ndodh, rrjedhimisht nuk po mund të arrini atë gradë të adhurimit shpirtëror – atëherë është koha që të kesh një bisedë serioze me zemrën tënde.

Pyete zemrën tënde: pse është kaq e ftohtë? Pse Fjalët e Krijuesit të saj nuk kanë fare ndikim në të? A është kaq arrogante sa që nuk ka nevojë për Zotin e saj?! Pse është kaq e vështirë? Pse nuk shprehen emocione, si nga frika, si nga gëzimi për të qenë me Krijuesin e saj? Pse është (zemër) hipokrite? Si ndodh që ajo qan duke shikuar një film, kur e di se nuk është i vërtetë, por nuk qan kur dëgjon të vërtetën që flet për destinacionin e tij final?!

Vazhdo të gërmosh më thellë derisa ta gjesh përgjigjen! Bëje zemrën tënde të thyhet para Allahut të Lartësuar këtë Ramazan. Nuk ka një ndjenjë më të ëmbël se një zemër e sinqertë që i thërret Allahut. Mos e lini Ramazanin të shkojë pa qarë qoftë edhe një herë para Zotit tuaj!



DITA 25

Një mënyrë praktike për të pastruar zemrën tënde!

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) ka thënë: **"Për çdo gjë që mban ndryshk ka një lustrim, kurse lustrim për zemrën është përmendja e Zotit."** (Buhariu).

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të!) ka thënë: **"Përtërijeni besimin tuaj!"** Thanë: **"O i Dërguar i Allahut, si ta përtërijmë besimin tonë?"** Ai ﷺ u përgjigj: **"Duke thënë shumë "La ilahe ilaAllah (Nuk ka Zot tjetër meritë për adhurim përveç Allahut)."** (Ahmedi dhe Hakimi).

Pra, ja ku e keni atë: dy receta të thjeshta për të zbutur zemrën tuaj, hiqni ndryshkun prej saj dhe ndjehu më afër Allahut të Lartësuar, veçanërisht në këto ditët e fundit të Ramazanit.

Provojeni sot. Thoni **"La ilahe ilaAllah"** në mënyrë të përsëritur - kur vozitni, kur uleni në kompjuter, kur gatvani ose luani me fëmijën tuaj - thjesht thuani dhe vazhdoni ta thoni!



DITA 26

A do të vijosh këtë rrugëtim?

Një ndjenjë "mërzie" na mbulon zemrat në këtë kohë çdo vit. Pyesim veten nëse do të vazhdojmë ndonjëherë të jemi kaq të pasur shpirtërisht dhe kaq afër Allahut të Lartësuar. Përvoja e kaluar ka treguar se ne gjithmonë dështojmë të vazhdojmë pas Ramazanit, kështu që çfarë mund të bëjmë për t'u siguruar që udhëtimi të mos mbarojë këtu?

Këtu është një video mbi këtë temë në të cilën unë ndaj me ju 6 këshilla. Një nga arsyet kryesore pse ne "biem" pas Ramazanit është se humbasim vetë-disiplinën. Ne kemi këtë ide të rreme në mendjen tonë se "Është Bajram! Bëni çfarë të doni!" (Edhe pse ne në fakt nuk e themi këtë, veprimet tona sigurisht që e bëjnë!)

Një nga mënyrat më të mira për ta luftuar këtë është të futni disiplinë në jetën tuaj që nga dita e parë e Bajramit. Nga dita e parë e Bajramit sigurohuni që të zgjoheni herët dhe të qëndroni zgjuar gjatë atyre orëve të para të mëngjesit! Pushoni këto orë të çmuara me lexim të qetë, duke bërë disa detyra të ruajtjes së shtëpisë, apo edhe duke i çuar fëmijët tuaj në park për një piknik të këndshëm.

Me këtë veprim të thjeshtë të zgjimit herët (të paktën për sabah) dhe qëndrimit zgjuar në ato orë të hershme, ju do të futni vetë-disiplinë në jetën tuaj, e cila do të rrezatojë në pjesën tjetër të ditës/veprimeve tuaja, Insha Allah. Gjithashtu, me këtë veprim të vetëm të thjeshtë, ju do të përgatiteni për një mënyrë jetese produktive dhe të shëndetshme pas Ramazanit që do t'ju ndihmojë gjatë gjithë vitit, Insha Allah.

PRODUCTIVE
RAMADAN.COM 

 Literatura
ISLAME

DITA 27

Vepra jote e fundit produktive

Për t'i dhënë fund këtij Ramazani duke u ndjerë të kënaqur, cila është gjëja e fundit produktive që duhet të bëni këtë Ramazan? Nuk keni nevojë të mendoni për këtë. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tashmë veç na ka treguar; Është dhënia e zekatit të fitrit!

Nëse mundeni, përpiquni që këtë Ramazan ta jepni vetë zekatin, në vend që ta bëni atë nëpërmjet ndonjë organizate bamirësie.

Është shumë e lehtë. Gjithçka që duhet të bëni është të ndiqni këto 3 hapa:

- Shkoni blini 3 kg oriz/hurma në emër të vetes + secilit prej anëtarëve të familjes suaj që ju mbështesni.
- Gjeni një person/familje muslimane nevojtare në zonën tuaj.
- Dërgoju vetë! (Nëse mund ta dorëzoni fshehurazi duke e lënë në pragun e tyre, do të ishte edhe më mirë).

Edhe pse është më e lehtë dhe me më pak telash ta bësh atë nëpërmjet një organizate bamirësie ose në internet, këto ditë, megjithatë është tjetër ndjenjë kur e bën atë fizikisht duke e dorëzuar me dorën tënde.

Allahu ua pranofte të gjitha veprat e mira në këto netë të fundit të bekuara!



DITA 28

Ramazani shkoi aq shpejt?

Nëse mendon se Ramazani kaloi kaq shpejt këtë vit, kjo është ose sepse kishe një Ramazan aq produktiv sa që koha fluturoi shpejt dhe nuk e ndjeve; OSE ishe aq i zënë sa nuk e vure re fare Ramazanin, përveçse në këto ditët e fundit.

Nëse keni pasur një Ramazan produktiv, një urim të përzemërt nga ekipi Muslimani Produktiv – lutemi që Allahu Subhanehu ue Teala t'i pranojë veprat tuaja dhe t'ju dhurojë shumë Ramazane edhe më produktive në vitet në vijim.

Nëse, për fat të keq, nuk e ke shfrytëzuar sa duhet Ramazanin dhe ke pasur vërtet një Ramazan joproduktiv, mos u dëshpëro.

Gjithçka që ju duhet tani është që t'i ktheheni sinqerisht Allahut të Lartësuar në këto orët e fundit para përfundimit të Ramazanit dhe të pendoheni tek Ai që e keni lënë këtë Ramazan t'ju rrëshqasë pa u përqendruar në të. Gjëja më e keqe që mund të bëni tani është të humbni shpresën në mëshirën e Allahut të Lartësuar. Pendohuni, jepini vetes shpresë dhe filloni të ndërmerri hapa konkretë për të përfituar sa më shumë nga Ramazani i vitit të ardhshëm, Insha Allah.



DITA 29

Si do të jeni pas Ramazanit?

Do të mundohem të hamendësoj atë që je duke menduar sot: po brengoseni (ose më saktë jeni në dyshim) nëse do të vazhdoni produktivitetin tuaj pas Ramazanit.

Unë nuk do t'ju jap leksione për rëndësinë e mbajtjes së produktivitetit tuaj (shpirtëror, fizik apo social) pas Ramazanit. Jam i sigurt se jeni duke marrë mjaftueshëm përkujtime nga imami dhe dijetarët vendas që po flasin për këtë. Por unë do të them vetëm këtë:

Nëse, në çdo moment gjatë 29 ditëve të fundit, keni ndjerë ëmbëlsinë e të qenit musliman dhe dëshironi që ajo ëmbëlsi të jetë me ju deri pas Ramazanit, atëherë duhet të vazhdoni të jeni produktiv shpirtërisht, fizikisht dhe në raportet tuaja sociale pas Ramazanit.

Si? Formula është shumë e thjeshtë: Kini synime të sinqerta dhe punoni shumë.

Për sot, po ju lë me këtë mendim.



DITA 30

Urime Bajrami dhe faleminderit!

Epo, ky është fundi i një muaji të gjatë e të bukur, por shpresojmë se fillimi i një jete të re produktive! 😊

Ekipi i ProductiveMuslim ju uron të gjithëve një Bajram të gëzuar, të bekuar dhe – sigurisht – produktiv!

Nëse dëshironi të qëndroni produktiv pas Ramazanit, vazhdoni të na vizitoni në faqet tona të internetit dhe mediat sociale më poshtë:

ProductiveMuslim.com

facebook.com/

ProductiveMuslim

@AbuProductive

youtube.com/

ProductiveMuslim

**Gëzohuni dhe kalofshi një Bajram të mbarë!
Ju lutemi na kujtoni në duatë tuaja!**



PRODUCTIVE
RAMADAN.COM 

 Literatura
ISLAME